REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

PROTOKOLLI 17

REND-DITE

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 21.09.2026 dhe 02.10.2026 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.
3. **Projekt-Vendim** "Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin shtator 2026, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%."
4. **Projekt-Vendim** "Për miratimin e ndihmës financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi Rezervë i Bashkisë".
5. **Projekt-Vendim** "Për miratimin e ndihmës financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi Rezervë i Bashkisë".
6. **Projekt-Vendim "**Për miratimin paraprak të vazhdimit të procedurave për dhënien me qira të pasurisë, me nr. 1120/56, z.k 3557 Taç Lart Kolonjë".
7. **Projekt-Vendim** "Për përfundimin e procedurës së kalimit të pronësisë mbi truallin e dhënë për ndërtim, në zbatim të vendimit nr. 11, datë 24.09.1993, të këshillit të komunës Leskovik dhe vkm nr. 329, datë 22.05.2019".
8. **Projekt-Vendim** "Për miratimin e linjave të transportit.**"**
9. **Projekt-Vendim** "Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore "Në vendimin nr.152, datë.22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e këshillit bashkiak nr.32 datë.20.02.2026"Për rishqyrtim të vendimit nr 27 datë 13.02.2026 "Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026".
10. **Projekt-Vendim** "Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore dhe transferim për Green Kolonja Sha" Në vendimin nr.152, datë.22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e këshillit bashkiak nr.32 datë.20.02.2026"Për rishqyrtim të vendimit nr 27 datë 13.02.2026 "Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026".
11. **Projekt-Vendim** "Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për rikonstruksion dhe rritje kapaciteti të hidrocentralit Leskovik 1 dhe Leskovik 2 nga shoqëria " Maksi Elektrik."
12. **Projekt-Vendim** "Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për zhvillim projekti per ndertimin e centralit fotovoltaik."
13. **Projekt-Vendim "**Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor investim në fushën e energjive të rinovueshme për ndërtim impianti fotovoltaik."
14. **Projekt-Vendim** "Për funksionimin e kopshteve dhe numrin e fëmijëve për çdo grup dhe ngarkesa mësimore të punonjësve arsimore në institucionet e arsimit parashkollor."
15. **Projekt-Vendim "**Për autorizimin e kryetarit të bashkisë Kolonjë ose të autorizuarit ligjor të tij për lidhje kontrate para noterit për shitjen e truallit të objektit".

16. **Projekt-Vendim** "Për një ndryshim në vendimin nr. 154 datë 22.12.2025 të këshillit bashkiak mbi miratimin e numrin e përgjithshëm të punonjësve të bashkisë Kolonjë dhe ndërmarrjeve të varësisë për vitin 2026."
17. **Projekt-Vendim** "Për shtesë fondi dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore, Në vendimin nr.152, datë.22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e këshillit bashkiak nr.32 datë.20.02.2026" Për rishqyrtim të vendimit nr 27 datë **13.02.2026 "Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026".**
18. **Projekt-Vendim** "Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore Në vendimin nr.152, datë.22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026."
19. **KËRKESË**

Të pranishëm: E.Isai, E.Xhelili, B.Jashari, I.Milo, G.Tafili, P.Çunge, Z.Meto, S.Kodra, E.Çikopana, I.Hodo.
Mungon: A.Zeneli, E.Avdi, A.Tartari, S.Larti, H.Iljazi, T.Çaçani.

E. Xhelili: Përshëndetje, fillojmë me mbledhjen rradhës së datës 29.10.2026, pika e parë e rendit të ditës. Jeni dakord me rendin e ditës?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Ka dikush prej jush konflikt interesi me ndonjë nga pikat e rendit të ditës?
E. Xhelili: Nuk ka asnjë konflikt interesi.
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 21.09.2026 dhe 02.10.2026, të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.
E. Xhelili: Jeni dakord me pikën dy të rendit të ditës?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili:Vazhdojmë me pikën tre të rendit të ditës "Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin shtator 2026, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%."
P.Çunge: Po shikojmë që një person është refuzuar nga sistemi ?
A.Dajlani: (Specialist i Shërbimit Social): Për muajin shtator janë rekomanduar të giitha familjet që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga sistemi, dhe është refuzuar familja e Ylli Çabej, përfitues nga fondi 6% i ndihmës ekonomike deri në muajin gusht dhe refuzuar për muajin shtator, pasi ka mbushur moshën për pension dhe ka nisur procedurat për përfitimin e pensionit nga Instituti i Sigurimeve Shoqerore.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën katër të rendit të ditës "Për miratimin e ndihmës financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi Rezervë i Bashkisë".
S.Kodara: Jemi dakord me projekt-vendimin.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën pesë të rendit të ditës "Për miratimin e ndihmës financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi Rezervë i Bashkisë".
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën gjashtë të rendit të ditës "Për miratimin paraprak të vazhdimit të procedurave për dhënien me qira të pasurisë, me nr. 1120/56, z.k 3557 Taç Lart Kolonjë".

I .Hodo: Jemi dakord.
P.Çunge: Kërkesën e kemi miratuar të paraqitur si hapjen e nje fabrike uji, sot është paraqitur projekt vendimi për hapjen e nje për dhënien me qira të pasurisë me numër 1120/56, Zona Kadastrale 3557 e cila do të përdoret për një fabrikë për përpunimin e qumeshtit dhe prodhimin e produkteve të tij, ne duam që si keto raste të kemi në rrethin e Kolonjë.
E.Isai: Çdo njeri që ka dëshirë të investoj në ndertesa që janë jashtë funksionit në pronësi të bashkisë Kolonjë mundet të vij kur të dëshiroj.
G.Tafili: Po mendojmë për një investim në shkollën Taç-Qëndër.
E.Isai: Diskutoheni dhe mendoj se është një mendim që ja vlen.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën shtatë të rendit të ditës "Për përfundimin e procedurës së kalimit të pronësisë mbi truallin e dhënë për ndërtim, në zbatim të vendimit nr. 11, datë 24.09.1993, të këshillit të komunës Leskovik dhe vkm nr. 329, datë 22.05.2019".
P.Çunge: Janë procedura.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën tetë të rendit të ditës "Për miratimin e linjave të transportit."
Z.Meto: Linjat e transportit për mësuesit dhe nxënësit që mësojnë jashtë vendbanimit miratohet për shkak të pagesës që marin në bazë të kilometrave ku ata janë.
I.Hodo: Fëmijët e fshatit Mollas e përfitojnë pagesën e linjës së transportit?
E.Dake (Drejtore e Arsimit dhe Edukimit të Fëmijëve): Jo sepse fëmijët në fshatin Mollas kanë shkollë ku mund të frekuentojnë mësimin, pagesa kryhet vetëm për fëmijët që nuk kanë institucionin ku të ndjekin mesimin në vendin ku ata banojnë.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën nëntë të rendit të ditës "Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore "Në vendimin nr.152, datë.22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e këshillit bashkiak nr.32 datë.20.02.2026"Për rishqyrtim të vendimit nr 27 datë 13.02.2026 "Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026".
E.Duro(Drejtor Finance): Meqënëse jemi në dy muajt e fundit të vitit është bërë një rishikim për të gjithë investimet e planifikuara për vitin 2026. Për ato investime që janë kryer diferenca midis vleres së kontratës dhe fondit limit do të meret për tu shpërndarë shpenzime të tjëra që na duhen, gjithashtu janë dhe disa investime që për arsye kohe nuk u arriten dot që të mbyllen plotësisht kete vit dhe ato lekë janë marrë për tu shpenzuar. Konkretisht janë prezantuar në relacion të gjithë zërat.
Z.Meto: Po shikoj që na janë paraqitur dy projekt vendime ku titullin e kanë afersish të njëjtë, pse janë fornatuar në dy projekt- vendime të ndryshëm? Kemi kerkuar që numrat e llogarisë të jenë më të qarta.
E.Duro (Drejtor Finance): Numrat e llogarisë janë të sqaruara të gjitha në relacion me rradhë.
Z. Meto: Po janë të shpjeguara por perseri nuk i kuptoj.
E.Duro(Drejtor Finance): Ky është formati që ne na kërkohet, kete pjesë ne nuk mund ta ndyshojmë.
E.Isai: Dega e thesarit e kerkon të paraqitur në atë format.
E.Duro: (Drejtor Finance): Po aty tregohet kodi buxhetor, kapitulli është llogaria, nuk mund ta ndryshojm formatin. Në relacion i kam shpjeguar të gjitha. Kalimin e transfertes tek Green Kolonja e kam formuluar në një projekt-vendim tjetër që të jemi më të qartë.

Z.Meto: Nga konfirmimi i mbledhjes së kaluar është vërejtur një gabim, do të lutesha mos bëhen më gabime për tju mbrojtur ju që e formuloni dhe ne që e miratojmë.
E.Duro(Drejtor Finance): Nuk do kemi gabime.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili:Vazhdojmë me pikën dhjetë të rendit të ditës "Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore dhe transferim për Green Kolonja Sha" Në vendimin nr.152, datë.22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e këshillit bashkiak nr.32 datë.20.02.2026" Për rishqyrtim të vendimit nr 27 datë 13.02.2026 "Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026".
E.Duro(Drejtoresh Finance): Tek rishpërndarjen e fondeve buxhetore për Green Kolonja Sha kemi fondi shtesë për paga dhe sigurime dhe detyrimet për aktivitetet e zhvilluara dhe financimi i aktiviteteve të planifikuara.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën njëmbëdhjetë të rendit të ditës "Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për rikonstruksion dhe rritje kapaciteti të hidrocentralit Leskovik 1 dhe Leskovik 2 nga shoqëria " Maksi Elektrik."
I.Milo: Do te bashkohen kanalet e hidrocentralit Leskovik 1 dhe Leskovik 2.
G.Eminaj (Drejtor Drejtoria e Pyjeve, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural): Po do të kryhej bashkimin e kanaleve per dy hidrocentralet.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën dymbëdhjetë të rendit të ditës "Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor për zhvillim projekti për ndërtimin e centralit fotovoltaik."
P.Çunge: Është zhvilluar dëgjesa publike.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën trembëdhjetë të rendit të ditës "Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor investim në fushën e energjive të rinovueshme për ndërtim impianti fotovoltaik."
G.Tafili: Edhe te ky projekt-vendim është zhvilluar dëgjesa publike.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën katermbëdhjetë të rendit të ditës "Për funksionimin e kopshteve dhe numrin e fëmijëve për çdo grup dhe ngarkesa mësimore të punonjësve arsimore në institucionet e arsimit parashkollor."
Z.Meto: Keni ndjekur udhezimin nr. 14 nga ministria e Arsimit.
E.Dake (Drejtor i Edukimit të Fëmijëve): Sipas situatës që arsimi parashkollor ndodhet në bashkinë tonë, ju bëjmë me dije se kërkojmë të ketë një numër më të vogël fëmijësh që frekuentojnë kopshtet si në qytet dhe në fshat me më pak se pesë fëmijë. Largësia e zonave rurale sjell në braktisjen e kopshtit dhe për këtë arsye kërkohet të miratohet numri më i vogël i fëmijëve në kopësht dhe ngarkesa mësimore e punonjësve në këto institucione.
E.Isai: Ky projekt vendim është miratuar dhe diku te dy tre vite me përpara.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën pesërmbëdhjetë të rendit të ditës "Për autorizimin e kryetarit të bashkisë Kolonjë ose të autorizuarit ligjor të tij për lidhje kontrate para noterit për shitjen e truallit të objektit".
G.Tafili: Projekt-Vendimi është për lidhjen e kontratës të shitjes së truallit me Trashëgimtarët e Spiro Sotir Ilia për pasurinë me nr. pasurie 4/140, volum 6, faqe 174, Z.K 1594, qyteti Ersekë dhe sipërfaqe trualli 300 m2.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën gjashtërmbëdhjetë të rendit të ditës "Për një ndryshim në vendimin nr. 154 datë 22.12.2025 të këshillit bashkiak mbi miratimin e numrin e përgjithshëm të punonjësve të bashkisë Kolonjë dhe ndërmarrjeve të varësisë për vitin 2026."
D.Tallo (Drejtor i Burimeve Njerëzore): Numri maksimal i punonjësve të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 është 260 punonjës dhe numri maksimal i punonjësve të "Green Kolonja" për vitin 2026 është 50 punonjës.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E.Xhelili: Janë propozar dy projekt vendime shtesë në rendin e ditës. A jeni dakord që këto projekt-vendime të shqyrtohen në mbledhjen e sotme?
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës "Për shtesë fondi dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore, në vendimin nr.152, datë.22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e këshillit bashkiak nr.32 datë.20.02.2026" Për rishqyrtim të vendimit nr 27 datë 13.02.2026 "Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026".
G.Tafili: Këshilli i Qarkut Korçë do të alokojë fondet për QKF me objekt Kolonia e Piktorëve dhe Fonde për "Green Kolonja Sha, Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Sportit" me object Windows Art.
P.Çunge: Ky projekt vendim kalon çdo vit.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën tetëmbëdhjetë të rendit të ditës "Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore në vendimin nr.152, datë.22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026."
E.Isai: Znj. Afroviti Koleci ka bere nje kërkesë drejtuar bashkisë Kolonjë për ndihmë financiare për përballimin e shpenzimeve mjekësore të djalit të saj.
I.Milo: E njohim si rast dhe jemi dakord me projekt-vendimin.
E. Xhelili: Jeni dakord me projekt vendimin?
Pro 9 Kundër 0 Miratohet

Proces-Verbali i datë 29.10.2026 është firmosur nga 9 anëtarë Këshilli.

SEKRETAR I KËSHILLIT
INSUIDA ORHANAS

KRYETAR I KËSHILLIT
ERALDO XHELILI